



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 11.11.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03L-040, nenit 8,9,1,10 dhe 13 shkronja d të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale dhe Përfundimit nr.06-75711-23/4 të miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të dt: 23.10.2015, me të cilin është miratuar propozimi i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për mbështetje financiare të projektit “Më mungon” të N.SH. “Industria Film”, me dt: 11.11.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e NSH “Industria Film” me seli në Prishtinë nr. 01-400-70522 e dt: 08.10.2015, për realizimin e projektit “Më mungon” të fotografit Artan Korenica, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në vlerë prej 1,000.00€ .

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 1,000.00€ nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e N.SH. “Indusrtia Film” nr. 1117006061000112, ProCredit Bank

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

4. Vendimi iu dorëzohet:

- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Znj. Blerta Basholli, nga Prishtina, Arberia 6, rr. “B. Curri” h II/12
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari-Lila